FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 7	**2003**	**Shkurt**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 655, datë 18.12.2002	Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile……	225
Vendim i GJK nr. 3, datë 13.2.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 1, datë 3.1.2003 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve……	228
Vendim i GJK nr. 4, datë 17.2.2003	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues i vendimit nr. 441, datë 26.9.2002 të Këshillit të Ministrave "Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve"……	236
Vendim i GJK nr. 5, datë 17.2.2003	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues i vendimit nr. 387, datë 13.6.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë……	237

V E N D I M
Nr. 655, datë 18.12.2002

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS SË SISTEMIT KOMBËTAR TË PLANIFIKIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 5, pika 1, 11, 1, 13 dhe 35 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen e sektorit të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile në strukturat e ministrive të mëposhtme:
- Ministrinë e Mbrojtjes
- Ministrinë e Rendit Publik
- Ministrinë e Shëndetësisë
- Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit
- Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit
- Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit
- Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës
- Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës.

2. Vendosjen e specialistëve për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në:
- Ministrinë e Mjedisit
- Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
-Ministrinë e Financave - Ministrinë e Drejtësisë
- Ministrinë e Ekonomisë
- Ministrinë e Punëve të Jashtme
- Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

3. Pranë ministrive të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi të funksionojë komisioni i planifikimit dhe i përballimit të emergjencave civile. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe përgjegjësitë përcaktohen nga ministri përkatës, në përputhje me nenin 11, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile". Detyrat e këtij komisioni përcaktohen në shtojcën "Rekomandime", që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Në strukturën e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, në Departamentin e Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile funksionon Qendra Kombëtare Operacionale për Emergjencat Civile, me strukturë të përhershme, në kohë normale dhe me strukturë të përkohshme, në raste emergjencash civile.

a) Struktura e përkohshme përbëhet nga ajo e përhershme dhe sipas llojit të emergjencës, thirren (ftohen) specialistë të ministrive e institucioneve të tjera, përfaqësues të Kryqit të Kuq Shqiptar dhe në rast nevoje edhe specialistë ndërkombëtarë.

b) Ministritë dhe institucionet përkatëse përzgjedhin dhe caktojnë 1-2 specialistë të fushës, që kanë të gjitha të dhënat e nevojshme për burimet e institucionit të tyre, si dhe autoritetin e domosdoshëm për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje.

5. Në përbërje të strukturës së administratës së prefektit ngrihet zyra e planifikimit dhe e përballimit të emergjencës civile, në nivel qarku.

a) Nën drejtimin e prefektit ngrihet dhe funksionon komisioni i planifikimit dhe i përballimit të emergjencave civile, në nivel qarku. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij komisioni përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

b) Në përbërje të organikës së zyrës së nënprefektit caktohet dhe inspektori për emergjencat civile.

6. Për organet vendore:

a) Në Bashkinë e Tiranës ngrihet zyra e planifikimit dhe e përballimit të emergjencave civile.

Struktura e kësaj zyre të jetë sipas lidhjes 1/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në strukturën e administratës së kryetarit të qarkut, të bashkisë dhe të komunës caktohet një

specialist me funksion të dytë, për mbulimin e problemeve të emergjencave civile.

7. Rekrutimi dhe trajtimi i personelit të strukturave të emergjencave civile.

a) Personeli, që do të rekrutohet në strukturat e mësipërme, të përzgjidhet nga kontigjenti i ish-ushtarakëve, sipas specifikave të institucioneve përkatëse.

b) Kriteret për përzgjedhjen e këtij personeli përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

c) Emërimi i personelit të emergjencave civile në administratën e prefektit bëhet nga prefekti, sipas procedurave të parashikuara nga ligjet në fuqi.

ç) Personeli i strukturave të emergjencave civile ka të njëjtin status me atë të personelit të institucionit që i përket.

d) Numri i punonjësve, fondi i pagave dhe shpenzimet e kësaj strukture të mbulohen nga buxheti vjetor i institucioneve përkatëse.

8. Vendkomandat e kohës së veçantë, të cilat kanë qenë në administrim të ish-këshillave të rretheve, kalojnë në administrimin e prefektit, kurse ato të komunitetit administrohen e mirëmbahen nga bashkitë dhe komunat.

9. Vendimi nr.292, datë 27.3.1995 i Këshillit të Ministrave "Për kalimin e shërbimit të MCR-së në Ministrinë e Brendshme" dhe çdo vendim e strukturë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

10. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, të gjitha ministritë dhe institucionet e tjera, të përcaktuara në këtë vendim, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1/a

Për administratën e organeve vendore:

A. Në Bashkinë e Tiranës krijohet zyra e emergjencës civile me:

1. Përgjegjës zyre1 (një) punonjës

Në bashki dhe komuna

I.Brenda limitit të personelit të administratës së bashkisë dhe komunës, caktohet një punonjës me një detyrë të dytë, për ndjekjen e problemeve të emergjencave civile.

Rekomandime

A. Për ministritë:

Bazuar në nenin 11, pikën 1 dhe 2 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", është përgjegjësi e çdo ministri për të ngritur dhe përcaktuar detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në linjën e ministrisë që drejton, por më poshtë jepen disa rekomandime.

Komisioni drejtohet nga titullari ose nga zëvendës i tij dhe mund të ketë në përbërje anëtarë të përhershëm ose të ndryshueshëm. Ai mund të mblidhet sa herë që e shikon të arsyeshme titullari.

Në këtë Komision marrin pjesë si anëtarë, drejtorë drejtorish, specialistë të fushës përkatëse, si dhe drejtorë ose kryeinxhinierë të ndërmarrjeve vartëse të ministrisë.
Ky Komision, ka këto detyra kryesore:

- përgatitjen e strategjisë, projekteve e programeve për parandalimin, planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile.
- miratimin e planit për përballimin e emergjencave civile në linjën e ministrisë, si pjesë e planit kombëtar të përballimit të emergjencave civile;
- ndjekjen e realizimit të detyrave në drejtim të masave parandaluese;
- përgatitjen e projektbuxhetit, si zë më vete për emergjencat civile;
- koordinimin mes drejtorive të dikasterit, drejtorive rajonale, drejtorive e ndërmarrjeve vartëse, të cilat kanë lidhje me emergjencat civile.

Disa nga detyrat e sektorit/specialistit të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile.

Sektori i emergjencave ose specialisti (koordinator) shërben si sekretariat për përgatitjen e mbledhjeve dhe të të gjithë punëve administrative që nevojiten për funksionimin normal të Komisionit.

Gjithashtu ky sektor do të marrë dhe përpunojë të dhënat në lidhje me resurset që ka vetë ministria, bazën e të dhënave materialo-teknike, që disponon ministria në linjën e saj, etj.

Sektori do të jetë pika e kontaktit e ministrisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Sektori i planifikimit për përballimin e emergjencave civile në ministri do të përgatisë programe, plane e skenare situatash emergjente, për trajnimin e personelit të ministrisë, forcave operacionale dhe ndërmarrjeve të varësisë si dhe biznesit privat natyra e aktivitetit të të cilëve lidhet me natyrën e ministrisë.

Ky sektor përveç detyrave të mësipërme ka dhe këto detyra:

- të përcaktojë rregullat e përdorimit të burimeve materiale e financiare në rastet e emergjencave civile;
- të bashkërendojë organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në rastet e emergjencave civile;
- të organizojë, zbatojë dhe monitorojë sistemin e të dhënave në nivel ministrie për situatat e emergjencave civile;
- të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, dhe riaftësimin e tyre, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse;
- të kontrollojë zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese në rastet e emergjencave civile;
- të hartojë udhëzime për institucionet, entet, drejtoritë rajonale, ndërmarrjet vartëse të tyre, për fushën e emergjencave civile.

B. Për qarkun, bashkinë dhe komunën:

Në zbatim të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 nenet 15, 16 dhe 17 përbërja, rregullat dhe mënyrat e funksionimit të komisionit të qarkut dhe komisionit vendor përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Rekrutimi i personelit

Specialistët e këtij sektori do të jenë ish ushtarakë të cilët do t'i nënshtrohen një testimi profesional të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Për Ministritë si ajo e shëndetësisë kandidatët do të jenë me edukim bazë sipas specialitetit të ministrisë përkatëse.

Këta punonjës gëzojnë status të njëjtë me atë që kanë institucionet përkatëse.

Nga paragrafët e mësipërm përjashtohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik, të cilët kanë status të veçantë dhe mund të plotësojnë organikën e sektorit me efektivat e tyre.

V E N D I M
Nr.3, datë 13.2.2003

NË EMËR TE REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi AbdiuKryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci Anëtar i““
Alfred Karamuço,Anëtar i““
Kristofor PeçiAnëtar i““
Kujtim PutoAnëtar i““
Xhezair ZaganjoriAnëtar i““
Petrit PlloçiAnëtar i ““
Sokol SadushiAnëtar i““

Gjergj SauliAnëtar i“‘

me sekretare Arbenka Lalica më datë 13.2.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.13 Akti, që i përket:

KËRKUES: FAHRI BALLIU, kandidat për deputet i Partisë Demokratike+Bashkimi për Fitore, përfaqësuar nga avokat Adnor Shameti, me prokurë.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Dëshira Mataj dhe Kleonard Pipa, juristë.

2. VALENTINA LESKAJ, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.1, datë 3.1.2003 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kërkuesi për shfuqizimin e vendimit të mësipërm ka parashtruar këto shkaqe:

- Kandidatja për deputete, Valentina Leskaj dhe stafi i saj kanë kryer veprime për blerjen e votës në mënyrë masive nëpërmjet shpërndarjes së ndihmave në zonën zgjedhore nr.52, duke cenuar kështu parimin e votës së lirë;
- Gjykata e faktit nuk ka shqyrtuar kërkesat për shtesat në listat e zgjedhësve dhe për këtë shkak, mbetën pa votuar me qindra zgjedhës;
- Bashkia e qytetit Elbasan, nuk ka marrë masa për pajisjen e zgjedhësve me Certifikatat e zyrës së gjendjes civile, gjë që ka penguar pjesëmarrjen e tyre në votim.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Gjergj Sauli, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kandidatja për deputete e Partisë Socialiste, Valentina Leskaj është shpallur deputete me vendimin nr.2, datë 29.12.2002 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.52, Elbasan.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.1, datë 3.1.2003, ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë, ku sipas të cilit Valentina Leskaj ka marrë 5179 vota, duke qenë kështu fituese, kurse Fahri Balliu 4607 vota.

Në kërkesën e paraqitur për shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkuesi ka pretenduar se gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve të datës 29.12.2002, janë kryer shkelje të ligjit, që kanë cenuar parimin e votës së lirë, të parashikuar nga neni 3 i Kodit Zgjedhor. Sipas tij, këto shkelje bëjnë të pavlefshme zgjedhjet në kuptim të nenit 113 shkronja “a” të këtij Kodi.

Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e paraqitura gjatë gjykimit të çështjes, arriti në përfundimin se kërkuesi nuk mundi të provojë pretendimet e parashtruara në kërkesë.

Sipas kërkuesit, kandidatja për deputete Valentina Leskaj dhe stafi i saj, kanë kryer veprën penale të blerjes së votës në mënyrë masive në zonën zgjedhore nr.52, Elbasan me anën e shpërndarjes së ndihmave ushqimore.

Në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë kësaj Gjykate nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kishte filluar procedimi penal, për veprën penale të parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. Duke qenë se çështja e ardhur në gjykim kishte lidhje me çështjen penale e nuk mund të përfundonte para saj dhe nisur nga kërkesa e nenit 48 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, që detyron shqyrtimin e çështjes brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të, Gjykata Kushtetuese pezulloi gjykimin deri në përfundimin e hetimit.

Prokuroria, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, pushoi hetimin e çështjes penale me vendimin e datës 24.1.2003 dhe Gjykata Kushtetuese rifilloi gjykimin e çështjes së pezulluar prej saj. Sipas vendimit të pushimit të ndjekjes penale, konstatohet fakti se “Programi Botëror i Ushqimit” dërgoi në Elbasan ndihma ushqimore për familjet e varfëra ekonomikisht dhe se 160 familje të zonës

zgjedhore nr.52 i kanë marrë ato një ditë para zgjedhjeve. Këtë fakt, prokuroria e ka quajtur të pamjaftueshëm për të nxjerrë përgjegjësi penale. Gjithashtu ajo arsyeton se gjatë hetimit të zhvilluar si nga pyetja e qytetarëve që kishin përfituar ndihma ushqimore, ashtu dhe nga administrimi i provave të tjera, vepra penale, e parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal, nuk u provua jo vetëm për stafin e kandidates për deputete, por as për persona të tjerë.

Veç sa sipër, në bazë të vendimit të prokurorisë, pretendimet e kërkuesit nuk u provuan as edhe me videokasetën e paraqitur prej tij si provë, pasi ajo përmbante pamje filmike të ndarjes së ndihmave dhe jo pamje ku të tregohej prania e Kastriot Shehut, vëllait të kandidates për deputete apo drejtues të stafit të saj elektoral.

Në rrethanat kur prokuroria nuk gjeti elementet e fajësisë së kandidates për deputete apo të stafit të saj dhe, kur nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezultojnë vërejtje nga anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit, ishte detyrë e kërkuesit të provonte se dhënia e ndihmave ushqimore 160 familjeve të zonës ka ndikuar në cenimin e parimit të votës së lirë dhe se ky cenim ka qenë i një shkalle të tillë që ka ndikuar në dhenien e mandatit.

Gjykata Kushtetuese, në shqyrtimin e këtyre çështjeve, zbaton rregullat e përgjithshme procedurale sipas të cilave barra e provës i përket kërkuesit, që në rastin konkret nuk paraqiti provat e nevojshme në këtë drejtim.

Edhe pretendimet e tjera të kërkuesit që lidhen me mohimin e të drejtës të votës së zgjedhësve, për shkak të refuzimit të bërë nga gjykata për shtesat në listat e zgjedhësve ose për shkak të mosmarrjes së masave për pajisjen e zgjedhësve me çertifikata të gjendjes civile nuk qëndrojnë. Ankimet për listat e zgjedhësve janë paraqitur jashtë afatit dhe me listë nga subjekti zgjedhor, në kushtet kur, sipas nenit 56 të Kodit Zgjedhor, këto ankime ka të drejtë t'i paraqesë në gjykatën e faktit çdo zgjedhës që nuk është regjistruar në listat e zgjedhësve, sipas procedurës të caktuar dhe afatit ligjor.

Veç sa sipër, këto pretendime nuk u shoqëruan me asnjë provë për të krijuar bindjen e gjykatës për vërtetësinë e parregullsive të tilla.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, arrin në përfundimin se kërkesa nuk gjen mbështetje në prova dhe në ligj, prandaj duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja "e" dhe 132 të Kushtetutës, në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" si dhe në nenin 113 të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Vendimi nr.1, datë 3.1.2003 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhej të shfuqizohej jo vetëm si i marrë në kundërshtim me ligjin e faktet, por mbi të gjitha si antikushtetues.

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte detyrën kushtetuese (neni 153) e ligjore (neni 18 i Kodit Zgjedhor) të verifikonte ankesën e kërkuesit lidhur me pretendimet e tij për shkelje të një karakteri shumë të rëndë të ndodhur në prag të votimeve në zonën zgjedhore nr.52. Nga provat e administruara, ka dalë plotësisht e provuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka bërë asnjë verifikim. Thirrja e biseda me anëtarët e Komisionit të Zonës Zgjedhore, nuk mund të zëvëndësojnë veprimet konkrete, praktika që mund dhe duhej të krijonte ky organ para se ai, nëpërmjet rrëzimit të kërkesës, të konfirmonte mungesën e shkeljeve të ligjit.

Në kushtet kur ky komision e ka detyrim të shqyrtojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të Komisionit të Zonës Zgjedhore, mungesa e verifikimit dhe prononcimi nëpërmjet vendimit të atakuar për mungesë të shkeljeve, e bën këtë vendim të cenueshëm përsa i përket

bazueshmërisë së tij.

2. Eshtë vërtetuar plotësisht se në vigjilje të zgjedhjeve, në datën28.12.2002, në zonën zgjedhore nr.52, janë kryer veprime haptazi të kundërligjshme, të cilat kanë kompromentuar votën e lirë e kanë cënuar integritetin e lirisë në zgjedhje.

Nga vendimi i pushimit të çështjes nga prokuroria e rrethit Elbasan si dhe nga dokumentet e paraqitura nga kërkuesi është vërtetuar plotësisht se:

a) ndihmat kanë ardhur për t'u shpërndarë kundrejt punës në gjelbërim, por janë shpërndarë pa u kryer kjo punë e duke falsifikuar listat, fakt për të cilin prokuroria ka filluar çështje penale;

b) ndihmat janë shpërndarë nga strukturat në varësi direkte të kandidates tjetër për deputete;

c) mbi 90 % e familjeve që kanë përfituar nga shpërndarja e ndihmave banojnë në zonën zgjedhore nr.52;

d) furnizimet, kryesisht, janë bërë ditën e heshtjes zgjedhore, në datën 28.12.2002.

Këto forma nuk kundërshtohen as nga pala e interesuar, megjithëse pretendohet se ushqimet janë shpërndarë në kuadrin e programit të ndihmave.

Duke u bërë shpërndarja e ndihmave në pjesën më të madhe në zonën nr.52 dhe brenda 24 orëve të fundit para votimit, mund të thuhet se vota e zgjedhësve që kanë përfituar prej tyre nuk ka qenë e lirë. Në bazë të ligjit edhe propaganda, që bëhet gjatë fushatës së zgjedhjeve, lejohet deri në 24 orë para votimit. Shpërndarja e ndihmave jo vetëm që ishte kryer brenda afatit prej 24 orësh para votimit, kur nuk lejohej propaganda, por për më tepër, kjo veprimtari ishte e kundërligjshme, sepse ka patur për qëllim blerjen e votës. Si e tillë, ajo edhe po të kryhej në një kohë të mëparshme, përsëri do të konsiderohej shkelje, sepse i kalon caqet e propagandës zgjedhore dhe përbën në vetvete vepër penale. Neni 328 i Kodit Penal ka si qëllim parandalimin e këtyre veprave sepse ato cenojnë direkt votën e lirë. Në këtë aspekt, është paradoksale të pranohet vetëm shkelja si e rëndë nga njëra anë (sepse në fakt ajo ishte e tillë përderisa përbën vepër penale) dhe, nga ana tjetër, të deklarohet se një shkelje e tillë nuk ka ndikuar në rezultatin zgjedhor. Është e qartë se kryerja e një veprimi të tillë ka dëmtuar rëndë procesin zgjedhor. Nga ana tjetër, në rastin konkret, kur diferenca mes dy kandidatëve ishte rreth 500 vota dhe në atë zonë të paktën 250 familje kanë përfituar ndihma, del se ndikimi i votës së tyre në rezultatin e zgjedhjeve ka qenë i dukshëm.

Veprimet e kryera për shpërndarjen e ndihmave dhe që kanë patur për qëllim blerjen e votës, kanë prekur esencën e konceptit kushtetues të votës së lirë, kanë dëmtuar procesin e votimit si një formë e shprehjes së vullnetit të lirë e të pakushtëzuar të zgjedhësve. Ato bien ndesh me parimet e shtetit ligjor dhe të zgjedhjeve të lira që qëndrojnë në themel të tij. Lejimi dhe pranimi i tyre kanë degjeneruar zgjedhjet në zonë dhe kanë krijuar imazhin negativ për organet që i administrojnë ato.

Normat kushtetuese e ligjore të standarteve bashkëkohore përbëjnë bazën për realizimin e zgjedhjeve të lira e demokratike. Por, që të garantohen plotësisht këto zgjedhje të lira, duhet që normat kushtetuese e ligjore të zbatohen pa asnjë lëshim, përndryshe vlera dhe qëllimi i tyre do të kompromentohej.

Në nenin 21 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut është përcaktuar se: "Vullneti i popullit është themeli i autoritetit të pushtetit publik; ky vullnet duhet të shprehet përmes zgjedhjeve të lira, që duhet të zhvillohen periodikisht me votim të përgjithshëm, të barabartë, të fshehtë ose sipas një procedure të barazvlefshme, që të sigurojë lirinë e votës".

Duke iu referuar kësaj dispozite, por edhe atyre kushtetuese e ligjore që u përmendën më lart, shtrohet pyetja se si mund të quhet votë e lirë ajo që është dhënë nën ndikimin dhe për shkak të përfitimit material në vigjilje të kryerjes së votimit.

Përderisa shkeljet kushtetuese e ligjore janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, siç parashikohet edhe në nenin 113 të Kodit Zgjedhor, përsëritja e tyre është e vetmja rrugë për të garantuar zgjedhje të lira e demokratike.

ANËTAR
K. Peçi, A. Karamuço

MENDIMI I PAKICËS

Në çështjen me kërkues zotin Fahri Balliu, ne kemi mendim të ndryshëm nga ai i shumicës, vetëm për pretendimin e tij lidhur me cënimin e lirisë së zgjedhjeve për këto arsye:

Zgjedhjet parlamentare janë një moment tepër i rëndësishëm dhe delikat për demokracinë si formë e qeverisjes. Vetëm përmes tyre bëhet e mundur legjitimimi në formë zinxhiri i pushtetit shtetëror, pasi ato transformojnë drejtpërsëdrejti vullnetin politik të popullit në organin qendror kushtetues. Pra, vullneti politik i populli si bartës i sovranitetit shtetëror, shqetësimet dhe kërkesat e tij në shoqërinë demokratike, bëhen të realizueshme kryesisht përmes përfaqësimit në Parlament. Pikërisht, për këtë arsye është mëse e domosdoshme që ky përfaqësim të jetë rezultat i një procesi të lirë, që mbështetet në kërkesat kushtetuese dhe në barazinë e të gjithë shtetasve pa përjashtim.

Sigurisht që gjatë fushatës elektorale subjektet zgjedhore kanë të drejtë që me mjete e mënyra të ligjshme, me programin dhe alternativat që ofrojnë, të përpiqen të ndikojnë sa më shumë tek zgjedhësit, për të siguruar votën e tyre. Por, ky proces duhet të jetë i lirë dhe i hapur, pa presione dhe pa u imponuar nga faktorë të jashtëm që nuk lidhen direkt me zgjedhjet, sepse në përfundim të këtij procesi çdo zgjedhës krijon vullnetin e tij politik dhe merr vendimin përkatës për të votuar. Për më tepër, në funksion të garantimit të kësaj lirie në marrjen e vendimit për votim, në përputhje me vullnetin politik, parashikohet që 24 orë para votimit të ndërpritet çdo lloj propagande apo fushate elektorale në favor të kandidatëve apo partive politike. Nga ana tjetër, organet shtetërore kanë për detyrë të qëndrojnë sa më neutrale në ballafaqimin politik gjatë fushatës së subjekteve zgjedhore, si dhe të marrin masat e duhura që garantojnë realisht lirinë e zgjedhjeve.

Këto kërkesa të rëndësishme evidentohen qartë në një sërë aktesh ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe për rrjedhojë edhe në kushtetutat dhe legjislacionet zgjedhorë bashkëkohorë të vendeve demokratike ose që janë në rrugën e demokracisë mes të cilëve, edhe në Kushtetutën dhe në legjislacionin zgjedhor të vendit tonë. Konkretisht, ndër të tjera mund të përmendim nenet 1/3 i Kushtetutës (Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira…); 2/1 e 2 të Kushtetutës (Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. Populli e ushtron sovranitetin përmes përfaqësuesve të tij…); neni 18 i Kushtetutës (Barazia e të gjithë shtetasve para ligjit); neni 3 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (E drejta për zgjedhje të lira); Akti Final i Helsinkit (Parimi VII – Respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore); Karta e Parisit për një Evropë të Re (Preambula – Qeverisja demokratike mbështetet në vullnetin e popullit, të shprehur … me anë të zgjedhjeve të lira e të ndershme"); neni 45/4 i Kushtetutës (Vota është vetiake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë); neni 3 paragagrafi 1 i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë (Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë…); nenet 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë (Fushata zgjedhore dhe të drejtat e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës); neni 328 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve … për të votuar "pro" ose "kundër"…), etj..

Duke patur parasysh edhe sa më sipër, për çështjen në shqyrtim kemi mendimin se me veprimet e kryera nga stafi elektoral ose njerëz në varësi të ish-kandidates Valentina Leskaj, në datën 28.12.2002, pra një ditë para zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve të pjesshme për deputetë në Kuvend për Zonën Zgjedhore nr.52, është cenuar ndjeshëm parimi i rëndësishëm i lirisë së zgjedhjeve, dhe në mënyrë të veçantë nenet 1/3 e 45/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 3 i Protokollit 1 të KEDNJ (Konventë që sipas nenit 122 të Kushtetutës përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik të Republikës së Shqipërisë); neni 3/1 dhe neni 129/2 i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë sepse:

1. Siç rezulton edhe nga vendimi për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr.740/2002, marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në datë 24.01.2003, është fakt se ditën e shtunë, më datën 28.12.2002 për 250 familje të qytetit të Elbasanit janë planifikuar dhe shpërndarë si ndihmë ekonomike sasira të konsiderueshme me miell, vaj dhe kripë. Nga verifikimi i listave, Prokuroria arrin në përfundimin se nga 250 familjet përfituese, rreth 90% e tyre janë familje që banojnë në zonën zgjedhore nr.52, Elbasan.

2. Ndihmat në fjalë janë dhënë në emër të "Programit Botëror të Ushqimit", por janë planifikuar dhe administruar nga Zyra Rajonale e Shërbimit Social Elbasan, e cila është në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale aty ku është ministre vetë ish-kandidatja për deputete e zonës nr.52, Valentina Leskaj.

3. Ndihmat duhej t'i përfitonte si shpërblim një kategori e caktuar njerëzish, konkretisht familjet e atyre personave që kishin realizuar 15 ditë pune vullnetare në "Gjelbërimi" ShPK, Elbasan. Nga vendimi i Prokurorisë rezulton se asnjë nga përfituesit nuk ka punuar për qëllimin e mësipërm.

Për këtë arsye, personat përgjegjës po hetohen për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve.

4. Veprimet e mësipërme nuk janë të rastësishme. Ndihmat u shpërndanë ditën e shtunë, datë 28.12.2000, një ditë para zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve në zonën nr.52, aq më tepër që në këtë ditë, ligjërish, ndalohet çdo lloj fushate apo propagande elektorale për subjektet zgjedhore që janë në konkurim. Ndihmat janë planifikuar dhe shpërndarë nga një mekanizëm në varësi të drejtpërdrejtë të ish-kandidates socialiste Valentina Leskaj, Ministre e Punës dhe Çështjeve Sociale. Nga kjo ndihmë përfitojnë jashtë kritereve të përcaktuara për këtë lloj ndihme pikërisht një numër i konsiderueshëm familjesh të zonës zgjedhore nr.52.

Sa më sipër, planifikimi dhe shpërndarja e ndihmave është bërë qëllimisht për të ndikuar në vullnetin politik të një numri të konsiderueshëm të zgjedhësve të Zonës Zgjedhore nr.52. Mjetet dhe mënyra e përdorur cenojnë dukshëm parimin e rëndësishëm të lirisë së zgjedhjeve aq më tepër që këto veprime bëhen një ditë para zhvillimit të tyre. Këto veprime janë kryer me synimin për të ndikuar tek zgjedhësit dhe duke patur parasysh numrin e përfituesve dhe diferencën ndërmjet kandidatëve mendojmë se ky veprim ka ndikuar potencialisht në rezultatin përfundimtar për shpalljen e kandidatit fitues.

Në këto rrethana, në bazë të nenit 141/1 të Kodit Zgjedhor, duhej të ishte pranuar kërkesa për anullimin e vendimit nr.1, datë 03.01.2003 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpallja si e pavlefshme e raundit të dytë të zgjedhjeve të pjesshme, për deputet të zhvilluara në datë 29.12.2002, në Zonën Zgjedhore nr.52.

ANËTAR
Xh. Zaganjori, P. Plloçi

ARSYETIM PARALEL

Bashkohem me shumicën vetëm për zgjidhjen e dhënë në dispozitivin e vendimit, por mendimi im ndryshon nga arsyetimi i vendimit të saj. Thelbi i mendimit ndryshe qëndron në konceptet jo të njëjta që ne kemi për përfshirjen e kësaj çështjeje në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Kërkuesi, nëpërmjet çështjes së ngritur përpara kësaj gjykate, kërkon pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.52, gjë e cila ka lidhje të drejtpërdrejtë me shpalljen të pavlefshëm të mandatit të fituar të deputetit.

Çështja, në fazën në të cilën ndodhet, paraqet një specifikë, për arsye se deputetja e shpallur me vendim të Komisionit të Zgjedhjeve të Zonës, ka bërë betimin në Kuvend, ndërkohë që Gjykata Kushtetuese shqyrtonte kërkesën e paraqitur nga kandidati i subjektit zgjedhor "Bashkimi për Fitore".

Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet kërkesës së paraqitur, i kërkohet pavlefshmëria e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka shpallur rezultatin përfundimtar për një deputete të Kuvendit, e cila e ka filluar ushtrimin e mandatit. Kërkesa e paraqitur, pretendimin kryesor për pavlefshmërinë e zgjedhjeve e ka mbështetur në shkeljen e lirisë së votës dhe në asnjë nga pikat e nenit 71 të Kushtetutës. Në këto kushte, çështja shtrohet nëse Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të heqë apo të shpallë të pavlefshëm mandatin e deputetit tej kufijve të nenit 71 të Kushtetutës.

Në këto kushte, referimi tek kjo dispozitë e Kushtetutës, që parashikon rastet se kur mandati i deputetit mbaron apo shpallet i pavlefshëm, merr rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Sipas nenit 71 të Kushtetutës, mandati i deputetit është i pavlefshëm vetëm në rastet kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë së parashikuar në nenin 69 të Kushtetutës, ndërsa për rastet e tjera ai konsiderohet se mbaron përpara afatit.

Për mendimin tim, neni 113 i Kodit Zgjedhor që parashikon pavlefshmërinë e zgjedhjeve duhet parë i lidhur ngushtë me nenet 71 dhe 72 të Kushtetutës. Betimi është një moment i rëndësishëm kushtetues, me të cilin lidhet fillimi i ushtrimit të mandatit të deputetit. Moskryerja vullnetarisht e betimit përbën njëkohësisht edhe çastin e mbarimit të mandatit të deputetit.

Duke iu referuar rastit në shqyrtim rezulton se pas shpalljes së vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kuvendi i Shqipërisë, pavarësisht se çështja ishte paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, organizoi ceremoninë e kryerjes së betimit të deputetes, duke përfituar nga ometimi ligjor apo kushtetues në këtë drejtim. Pikërisht në kushtet kur deputetja ka kryer betimin dhe

ka filluar ushtrimin e mandatit mendoj se çështja del jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë nuk mund të shpallet i pavlefshëm, ndërkohë që neni 71 i Kushtetutës nuk e parashikon rastin e pavlefshmërisë së mandatit si rrjedhojë e shpalljes së pavlefshmërisë së zgjedhjeve.

Ndryshe janë paraqitur rastet për shqyrtim në këtë gjykatë gjatë periudhës zgjedhore, sepse Kuvendi ende nuk ishte konstituar dhe nuk kishte filluar ushtrimin e veprimtarisë së tij. Megjithatë, pavarësisht nga ky fakt, i qëndroj mendimit se jurisprudenca kushtetuese nuk mund të bëhet pengesë për evoluim në pikëpamjet e gjyqtarëve të saj. Do ta konsideroja më të drejtë përsosjen dhe avancimin e pikëpamjeve, duke e harmonizuar me konceptet që njeh Kushtetuta në këtë drejtim, sesa të zbatoja mekanikisht qëndrimet e mbajtura deri vonë në praktikën kushtetuese, e cila është konsideruar në polemikat doktrinare si tejkalim i kompetencave të saj.

Çështja duket sikur përbën një problem kushtetutshmërie përsa i përket të drejtës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që në bazë të nenit 113 të Kodit Zgjedhor të shpallë të pavlefshme zgjedhjet, por kjo nuk është aktualisht objekt shqyrtimi. Në fakt pavlefshmëria e zgjedhjeve që shpall Komisioni Qendror i Zgjedhjeve heq apo bën të pavlefshëm mandatin e deputetit që e ka dhënë KZZ-ja. Pra, Kodi Zgjedhor e parashikon heqjen e mandatit të një deputeti për efekt të pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Me këtë konstatim nuk dua të vë në diskutim kushtetutshmërinë e nenit 113 të Kodit Zgjedhor, sepse kjo dispozitë është ende në fuqi dhe prezumohet kushtetutshmëria e saj, por jam i mendimit se Gjykata Kushtetuese në zgjidhjen e çështjes duhet t'i referohet dhe të orientohet nga konceptet kushtetuese të pavlefshmërisë apo të heqjes së mandatit të deputetit, të cilat janë tepër të kufizuara.

Verifikimi i zgjedhjes së deputetit që parashikohet në nenin 131, shkronja "e" e Kushtetutës është një kompetencë e kësaj gjykate, por ajo duhet parë e lidhur ngushtë me konceptin e pavlefshmërisë dhe të heqjes së mandatit të deputetit. Ajo që parashikohet në Kushtetutë lidhet me pamundësinë e Gjykatës Kushtetuese, që tej rasteve të nenit 71 të shpallë pavlefshmërinë e mandatit të një deputeti të zgjedhur. Mandati i deputetit të zgjedhur nuk mund të preket në tejkalim të neneve apo dhe të koncepteve të Kushtetutës. Prandaj për këto arsye, çështja objekt shqyrtimi mbetet jashtë juridiksionit kushtetues dhe për rrjedhojë kërkesa, me këtë arsyetim, konsiderohet e rrëzuar.

ANËTAR
S. Sadushi

V E N D I M
Nr. 4, datë 17.2.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi AbdiuKryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija VuciAnëtar i“ “
Gjergj SauliAnëtar i““
Alfred KaramuçoAnëtar i““
Kristofor PeçiAnëtar i““
Kujtim PutoAnëtar i“ “
Xhezair ZaganjoriAnëtar i“ “
Petrit PlloçiAnëtar i“ “
Sokol SadushiAnëtar i““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 29.1.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.255/10 Akti që i përket:

KËRKUES:
1. AVOKATI I POPULLIT
2. SHOQATA E NDERTUESVE TË SHQIPËRISË, në mungesë.
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.
2. MINISTRIA E RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TURIZMIT, në mungesë.
3. SHOQËRIA "EUROVINI" SH.P.K, përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka.
OBJEKTI: Shfuqizimin si antikushtetues i vendimit nr 441, datë 26.9.2002 të Këshillit të Ministrave "Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve".

Kërkuesit, nëpërmjet një kërkese të përbashkët, pretendojnë se vendimi i sipërcituar i Këshillit të Ministrave është antikushtetues dhe parashtrojnë këto shkaqe për shfuqizimin e tij:
Së pari, ndalimi pa kufizim i veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve penalizon pa të drejtë të gjithë subjektet pa dallim dhe shkel nenet 11 dhe 44/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Së dyti, kufizimi i veprimtarisë ekonomike të këtyre subjekteve është bërë me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe jo me ligj, siç përcaktohet ne nenin 11/3 të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushin, Avokatin e Popullit, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe pasi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në seancë gjyqësore, Avokati i Popullit hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës me arsyetimin se Këshilli i Ministrave, gjatë kohës që çështja ishte paraqitur për shqyrtim në këtë gjykatë, ka nxjerrë një vendim nëpërmjet të cilit ndryshon pikat 1 dhe 2 të Vendimit objekt kërkese. Me kërkesën e Avokatit të Popullit u bashkua dhe përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Shoqëria "EUROVINI" SH.P.K.
Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, e cila është në pozitën e kërkuesit në këtë çështje, nuk është paraqitur në të dy seancat gjyqësore që janë zhvilluar pranë Gjykatës Kushtetuese.
Në këto kushte, përderisa Avokati i Popullit hoqi dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm i kësaj çështjeje dhe Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, megjithëse vërtetohet se ka marrë dijeni rregullisht për datat e zhvillimit të seancave gjyqësore dhe nuk është paraqitur në gjykim, pa shkak të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese çmon se çështja duhet të pushohet.

PËR KETO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 e 132 të Kushtetutës si dhe në nenet 1 pika 2 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.5, datë 17.2.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi AbdiuKryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija VuciAnëtar i“““
Gjergj SauliAnëtar i“““
Alfred KaramuçoAnëtar i“““
Kujtim PutoAnëtar i “““
Xhezair ZaganjoriAnëtar i“““
Petrit PlloçiAnëtar i “““
Sokol SadushiAnëtar i “““
Kristofor PeçiAnëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 20.01.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.12 Akti që i përket:

KËRKUES: HYQMET PISHA, përfaqësuar nga avokat Selfo Dosti, me prokurë.
SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PERGJITHSHME, në mungesë.
OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.387, datë 13.6.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
BAZA LIGJORE: Nenet 31/b, 31/1, 42/1, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të sipërm:
- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka gjykuar çështjen pa marrë njoftim i pandehuri për bërjen e rekursit nga prokurori, duke shkelur kërkesat e nenit 414 të Kodit të Procedurës Penale, për njoftimin e ankimit;
- Gjykimi i çështjes është bërë në mungesë të të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij pa patur dijeni për ditën e gjykimit dhe pa u marrë asnjë masë për ta lajmëruar;
- Shkeljet e përmendura cënojnë parimin e mbrojtjes në gjykim dhe e bëjnë procesin të parregullt.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr.159, datë 22.12.2000, ndër të tjera ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit Hyqmet Pisha për veprat penale të vrasjes me paramendim, të kryer në bashkëpunim dhe të mbajtjes pa leje të armës luftarake dhe në bazë të neneve 78, 25, 278/2 dhe 55 të Kodit Penal e ka dënuar me 17 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.57, datë 15.03.2001, ka prishur vendimin e gjykatës së rrethit dhe ka pushuar gjykimin e çështjes për këtë të pandehur, pasi nuk vërtetohet fajësia.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.378, datë 13.6.2002, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

Nga materialet e dosjes nuk vërtetohet që të pandehurit apo mbrojtësit të tij t’i jetë komunikuar rekursi i prokurorit. Mosnjoftimi i rekursit vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 414 të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet se “akti i ankimit i njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private, nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin”. Mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor nuk i ka dhënë mundësi të pandehurit të dijë që çështja e tij do të paraqitej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe të njihej me shkaqet e parashtruara në rekurs, duke i mohuar kështu të drejtën për t’u mbrojtur.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, e ka gjykuar çështjen në mungesë të mbrojtësit të të pandehurit, pa verifikuar arsyet e mosparaqitjes, sepse nga dosja rezulton se as i pandehuri dhe as mbrojtësi i tij nuk kanë pasur dijeni për ushtrimin e rekursit nga prokurori dhe për ditën e gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Duke qëndruar çështja si më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se:

- Për të garantuar një proces penal të drejtë, ka rëndësi themelore që i akuzuari të marrë pjesë dhe të mbrohet në gjykim dhe në rast mosparaqitje të tij, nuk mund të gjykohet pa iu siguruar më parë mbrojtja me avokat. Qëndrimi i kundërt vjen ndesh me nenin 42 të Kushtetutës dhe me kërkesat e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

- Që e drejta e mbrojtjes me avokat të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por edhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve;

- Mosnjoftimi i kërkuesit dhe i mbrojtësit për rekursin e prokurorit kundër vendimit të gjykatës së apelit, që e kishte deklaruar atë të pafajshëm, si dhe mosmarrja pjesë e tyre në seancë gjyqësore për shkak se nuk janë njoftuar, u ka hequr mundësinë për të realizuar mbrojtjen. Një qëndrim i tillë vjen në kundërshtim me nenin 6/3 shkronja "c" të Konventës dhe nenin 31/ç të Kushtetutës, sipas të cilave çdo i akuzuar ka të drejtë, "... të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij";

- Ashtu siç përcaktohet në Kushtetutë dhe në Konventë, pjesëmarrja në gjykim dhe ushtrimi i së drejtës së mbrojtjes, janë aspekte të procesit të rregullt ligjor, të lidhura mes tyre dhe që plotësojnë njëra-tjetrën për garantimin e të drejtës së mbrojtjes. Si e tillë, e drejta e mbrojtjes nuk mund të mohohet dhe as të reduktohet. Edhe në rast se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk pranon të marrë pjesë vetë në gjykim, atij duhet t'i garantohet e drejta për t'u mbrojtur me avokat;

- Mossigurimi i pjesëmarrjes në gjykim të të akuzuarit, në çdo rast, por dhe atëherë kur ky i fundit i fshihet drejtësisë, nuk mund të përligjë zhvillimin e procesit kundër tij pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e mbrojtësit. Parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal, kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëlloj si ato të prokurorit. Ky parim presupozon që secilës palë, duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër. Në rastin konkret, kërkuesit nuk i është krijuar një mundësi e tillë. Përkundrazi, gjykata duke dëgjuar vetëm argumentet e prokurorit të ngritura në rekurs dhe të parashtruara në seancë dhe duke mos dëgjuar pretendimet e kërkuesit (aq më tepër që ky i fundit nuk ka dijeni për rekursin), i ka dhënë procesit gjyqësor zhvillim të njëanshëm;

- Në analizë të fundit, kërkuesi pretendon për proces të parregullt, sepse kundër tij u dha vendimi i formës së prerë pa u njoftuar për rekursin e prokurorit kundër vendimit që e kishte deklaruar atë të pafajshëm dhe pa u mbrojtur ndaj akuzës nëpërmjet avokatit të caktuar prej tij;

- Siç ve në dukje Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vendimin për çështjen "Lala" kundër Hollandës: "Për t'u konsideruar i drejtë procesi gjyqësor penal, është me rëndësi vendimtare që të akuzuarit t'i sigurohet mbrojtje efektive jo vetëm në shkallë të parë, por edhe në apel, bile me përparësi për këtë të fundit".

Në pikëpamjen e Gjykatës Kushtetuese është e papranueshme që neni 6/1 i Konventës të përshkruajë me hollësi garancitë procedurale që u ofrohen palëve në gjykim dhe të mos mbrojë në radhë të parë atë të drejtë, e cila bën të mundur realizimin e këtyre të drejtave të tjera dhe që është pjesëmarrja në gjykim. Në rast se një pjesëmarrje e tillë mungon, nuk mund të bëhet fjalë për proces të rregullt.

E drejta për të marrë pjesë në gjykim, presupozon jo vetëm pjesëmarrjen fizike të palës, por krijimin për të të mundësive që duke njohur pretendimet e palës tjetër, të jetë në gjendje të parashikojë prapësimet dhe pretendimet e saj. Kjo nuk është një kërkesë formale dhe pa rëndësi, por substanciale dhe e domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave të palës, sepse vetëm në këtë mënyrë sigurohet roli i paanshëm i gjykatës dhe i jepet asaj mundësia reale të shprehë me vendim opinionin për çështjen, pa cenuar rregullsinë e procesit.

Duke shqyrtuar çështje të kësaj natyre për shkelje të së drejtës kushtetuese të shtetasve për një proces të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese synon të konfirmojë atë praktikë të saj për zbatimin me korrektësi e konsekuencë të kërkesave të nenit 6 të Konventës dhe dispozitave kushtetuese si dhe

jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Me këtë rast Gjykata Kushtetuese ve në dukje se në një shtet ligjor, kërkesat e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dispozitat e Kushtetutës që garantojnë të drejtën e individit për proces të rregullt ligjor, duhet të zbatohen pa asnjë rezervë dhe se shkelja e tyre duhet t'i nënshtrohet një kontrolli të rreptë dhe efektiv për të siguruar realisht të drejtat kushtetuese.

Në këto kushte, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është rezultat i një procesi të parregullt ligjor që i ka mohuar këto të drejta dhe duhet të shfuqizohet si antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.387, datë 13.6.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimi e çështjes për shqyrtim Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

Kodi Penal

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Mars, 2002

Kodi i Procedurës Penale

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Shtator, 2002

Kodi i Procedurës Civile

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Korrik, 2002

Kodi Rrugor

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Qershor,2002

Kodi Penal Ushtarak

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Tetor, 2002

Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Tetor, 2002

U dorëzua për shtyp më 24.2.2003
Doli nga shtypi më 25.2.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë